



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1067

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv. Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i paisjeve mjekësore” me numër të prokurimit 615-24-4154-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PODUJEVËS”, më 10/01/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e “PRO MEDICAL” SH.P.K. me nr. 2024/1067, e datës 04/11/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i paisjeve mjekësore”, me numër të prokurimit 615-24-4154-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PODUJEVËS”. **mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.**

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankesues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.04.2024, “KOMUNA E PODUJEVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i paisjeve mjekësore” me numër të prokurimit 615-24-4154-2-2-1, ndërsa Vendimi i Autoritetit Kontraktues është ngritur me datën 18.10.2024 për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 €.

Me 23.10.2024, OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.10.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04/11/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr. 2024/1067 lidhur me aktivitetin “Servisimi i paisjeve mjekësore” me numër të prokurimit 615-24-4154-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: Zyrtari përgjegjës i prokurimit, kërkesen për ri shqyrtim te OE ankues e kualifikon si te pa bazuar, per faktin se ky aktivitet i prokurimit disa here është kthyer ne ri vlerësim nga AK – Komuna Podujevë për qellim te vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit te ofertave ne atë mënyrë qe te konfirmohet sakt nese operoret ekonomik pjesemarrës kane dorezuar dëshmi ashtu siç është kerkuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate.

AK - Komuna Podujevë, ka autorizuar komisionin ri vlerësues profesional, ne atë mënyrë qe te realizohet vlerësim korrekt dhe te konfirmohet nese ju si OE keni prezantuar dëshmi sipas kërkeses se vendosur ne dosje te tenderit si rrjedhoj komisioni vlerësues ka konstatuar se nuk e mbuloni kërkesen lidhur me “Serviserin e certifikuar nga prodhuesi për servisimin e aparateve mjekësore te aplikuara ne lotin II”. Ne ofertën tuaj është dorëzuar certifikata ne emer te Z. Nazim Lohaj e cila nuk e ploteson kërkesen e përcaktuar si dhe certifikatat ne emer te z. Lohaj janë te pa shfuqizuara dhe nuk i pergjigjen paisjeve te cilat duhet te servisohen.

Për këtë qeshtje eshe OSHP, me vendimin e datës 24.09.2024, me nr. 2024/0666, është vendosur lidhur me pergjegjesin e ofertës suaj.

Edhe me raportin e ekspertizes dhe te konfirmuar nga PSH është potencuar si me poshte: Eksperti shqyrtues, njëherit sqaron se OE ankues e ka bashkangjitur ne ankese edhe deklaratën Genius Kosova - distributor/përfaqësues i Shenzhei Mindray Bio Medical Electronics Co, Ltd, i cili ka deklaruar se nuk e mbështesim OE Pro Medical. Duke u bazuar ne sqarime e dhëna me larte, eksperti shqyrtues vlerëson se certifikatat e serviserit N.Lohaj nuk janë valide dhe pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse ne deklaratën e Shenzhei Mindray Bio Medical Electronics Co, Ltd dhe deklaratën e distributorit Genius Kosova, qarte thuhet se certifikatat nuk janë valide dhe se i rekomanduari për kontrate nuk e ka mbështetjen tone.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "PRO MEDICAL" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: AK- KOMUNA E PODUJEVËS ne aktivitetin e Servisimi i paisjeve mjekësore-LOT 2- Servisimi i paisjeve Laboratorike në QKMF ky aktivitetet i prokurimit te larteshenuar është bërë në kundërshtim me LPP ku ne më poshtë shtjellojm pretendimet tona.

Oferta jone ka qene 1152.50 Euro e jo siq keni cekur ju ne LS 14,974.50 euro kurse ju keni rekomandaur per kontrate OE me cmimi 100% me shtrenje se ofera jone. Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese , por ne kemi vrejtur se nuk jemi trajtuar si barabartë nga AK ku ne vijm do paraqesim fakte dhe shëshmit gjithashtu edhe pretendimet tona anikmore se vlersimi nuk është bërë konfrom LPP Neni 59. Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlersimit të ofertës të OE "Pro Medical.

Pretendimi i pare ankimor.

Ne ne DT tek FDT si kriter per LOT 2 si Kerkesa 1 ka qenë si:

Pra duke u bazuar ne DT si kriter ja qenë: 1.Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon së paku një serviser të certifikuar nga prodhuesi për servisimin e aparateve mjekësore per Lot I dhe së paku një serviser të certifikuar nga prodhuesi për servisimin e aparateve mjekësore për Lot II. Ju informojmë se certifikatat e dorëzuara mbulojnë pajisje të markave dhe prodhuesve të ndryshëm.

Pra AK, u ka dhënë mundësi më shumë OE të marrin pjesë në këtë tender, duke mundësuar kështu që AK të kursejë paranë publike, siç përcaktohet në Nenin 6 të LPP. AK ka respektuar LPP-në, sidomos Nenin 7, duke mos favorizuar ndonjë OE të caktuar.

Ne jemi eliminuar me arsyetimet e cekura më poshtë, të cilat arsyetim është ju imponuar AK nga OE ankuese dhe tani i rekomanduar, ky arsyetim nuk qëndron, pasi AK-ja është bazuar vetëm tek certifikata e punëtorit Nazim Lohaj, duke mos marr parasysh cerficate tjera qe kemi dorzuar. Ju keni bërë rivlerësim në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP).

Arsyeja e eliminimit tonë: Ju, si Autoritet Kontraktues (AK), duhet të keni parasysh se në paramasë janë përfshirë gjashtë (6) pajisje të ndryshme, si: Analizatori Hematologjik, Analizatori Biokimik, Mikroskopi Laboratorik, Centrifuga, Sterilizatori dhe Fotometri. Ndërsa në Dosjen e Tenderit (DT) nuk e keni specifikuar që certifikata duhet të jetë për një markë apo prodhues të caktuar. Kjo është imponuar nga Operatori Ekonomik (OE) ankues ose tashmë i rekomanduar. Gjithashtu, lidhur me pjesët rezervë, nuk kemi asnjë marrëveshje me OE Genius Kosova, sepse ne kemi mundësi të tjera furnizimit me pjesë rezervë, kurse ne furnizohemi nga partnerët tanë afaristë, fakt të cilin e kemi dëshmuar edhe në dokumentet e dorëzuara gjatë ofertimit si dokumenti Kerkesa 2 Marrëveshja kontraktuale me prodhuesin ose distributorin për furnizime me pjesë rezerve.pdf. sepse ne maramase ka pasijet tjera pra 6 lloje te ndryshme. Ju informojmë se kontrata të ngjashme për pajisje të njëjta kemi realizuar në vlerë mbi 427,000 euro dhe nuk

kemi asnje pengese ne ralizim dhe furnizim. Për më shumë detaje, shikoni listën e kontratave si dëshmi.

Certifikatat tona plotësojnë kërkesat e standardeve DT dhe tejkalojnë kërkesat minimale të AK. Cerfikate e stafit të cilët janë të cerfikuar dhe trajnuar per servisim dhe mirëmbatjen e paisjeve IVD pra te laboratorit te gjitha paisjet pra termi IVD laboratorit pra In Vitro Diagnostic devices (IVD) ku përfshihet edhe Aparati hematologjik dhe pasije tjera te laboratorit sepse, pra ne grupin IVD bejen pjese pra një game më të gjerë pajisjesh të laboratorit ose grupeve të pajisjeve të Diagnostifikimit In Vitro (IVD) si: Analizatori Kimik Automatik , Analizator Kimik Semi-Automatik, Analizatori i Koagulacionit Semi-Automatik, Analizatori i Hematologjisë Automatik kurse në DT si kriterë ka qenë si” një serviser të çertifikuar nga prodhuesi për servisimin e aparateve mjekësore për Lot II pra nuk është përcaktuar ndonjë prodhues specifik në specifikime tek kriterin ne DT dhe për këtë përgëzojmë AK, sepse nuk ka krijuar monopol duke favorizuar ndonjë OE, ju lutem shikoni dëshmi 1 Cerfikate për Adnan Bala.

Ju lutem shikoni dëshmi 2 Cerfikate për Nazim Lohaj , shiko foto e bashkangjiture se ne cilin folder jane keto cerfikata ne dokumentet tona.

Në anën tjetër, OE ankuese ose tani i rekomandaur nuk ka shfaqur gjendje fakti ne Ankesen e dorzuar ne OSHP dhe ka vene ne lajdhitje edhe PSH duke kërkon ti imponojë AK-së krijimin e një monopoli duke kërkuar certifikatë për prodhuesit specifikë, gjë që do të ishte në kundërshtim me Nenin 7 dhe Nenin 1 të LPP-së. Këto certifikatë mbulon këtë fushë dhe tejkalon kërkesat minimale të AK të cekura në DT. Pajisjet e laboratorit i përkasin kategorisë së pajisjeve për diagnostikimin in vitro (IVD). Ju lutem shikoni certifikatën e bashkangjitur më poshtë me këtë shkresë.

Ju, si Autoritet Kontraktues (AK), duhet të keni parasysh se nuk ekziston asnjë ligj apo normë ndërkombëtare që lejon anulimin e një trajnimi ose certifikate, siç pretendon OE-ja ankuese kurse tani i rekomanduar për kontratëpa arsytimi juaj për eliminimin tone është pa qëndrueshëm. Certifikata është e vlefshme deri më 10/2025, por OE-ja ankuese, tani i rekomanduar në bashkëpunim me OE GeniusKosova, dëshiron ti mohojë të drejtat elementare punëtorit tonë, duke i ndaluar ushtrimin e profesionit. Njohuritë e fituara nga trajnimet nuk mund të anulohen apo mohohen nga këta OE të ankuara.

Siç dihet, ky punëtor është pjesë e kompanisë Pro Medical prej një kohe të gjatë, gjë që mund të dëshmohet edhe përmes listës së pagave nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Edhe nëse certifikata në fjalë nuk pranohet, ne kemi dorëzuar gjithashtu dy certifikata të tjera valide për Adnan Bala dhe Nazim Lohaj, siç dëshmohet me dokumentet përkatëse (Deshmia 1 dhe Deshmia 2, shih më lart)

Sa i përket dokumentit të përmendur më poshtë, ne kemi alternativa të tjera të furnizimit dhe nuk jemi të varur nga ky OE. Dokumenti i përdorur si dëshmi nga OE-ja ankuese dhe tani i rekomanduar, vetëm sa ka çuar në konfuzion në OSHP. Ky dokument nuk është relevant dhe nuk mund të përdoret si bazë për eliminimin tonë.

OE-ja ankuese dhe OE Genius Kosova, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë përpiluar këtë deklaratë, edhe pse nuk ka qenë dokument që ne kemi dorëzuar në këtë aktivitet të prokurimit. Ne asnjëherë nuk kemi deklaruar se do të mbështetemi nga OE Genius Kosova për këtë proces.

Ne kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues (AK) që të bazohet në Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe të mos bjerë nën ndikimin e Operatorit Ekonomik (OE) ankues, tani të rekomanduar. Gjithashtu, nuk duhet të mbështetet në Vendimin e OSHP-së, pasi OE-ja nuk ka paraqitur fakte të qëndrueshme dhe, në kundërshtim me LPP-në, ka dorëzuar dokumente ose prova të sajuara, të cilat synojnë vetëm të mbështesin pretendimet e tij në ankesë, pa u bazuar në Dosjen e Tenderit (DT).

Në DT nuk është përcaktuar se çfarë certifikate duhet të posedojë një pajisje e një marke të caktuar, dhe për më tepër, në paramasë ka një diversitet të pajisjeve të ndryshme. Ndërkohë, OE ankues dhe tani i rekomanduar është fokusuar vetëm në një pajisje specifike, të cilën ai e ka instaluar edhe në QKMF në Podujevë, duke u përpjekur me çdo kusht të krijojë një monopol. Gjithashtu, siç vërehet, çmimi i ofertuar është dukshëm mbi çmimin e tregut, madje 100% më i shtrenjtë

Operatori ekonomik ankues pretendon shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së: nenin 7, 59 të LPP dhe Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik 41. Për këtë arsye, AK duhet të zbatojë nenin 6 të LPP-së dhe të mos dëmtojë buxhetin e komunës duke rekomanduar një OE që ka ofertuar me një çmim të tepruar. **VENDIMI I. APROVOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe lenda te kthehet ne **II. RIVLERESIM**, dhe gjate fazes se rivleresimit AK te merr parasysh LPP-NË

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 06/11/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1067/24, ndërsa me datë 18/11/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1067 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK nuk ka dhen përgjigje me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje rreth raportit te ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante

lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1067 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, i pakënaqur me vendimin B58 ka dorëzuar ankese ne OSHP, me pretendimin se nuk është bere rivlerësimi i ofertave konform dispozitave ligjore te LPP-se.

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron, se për këtë aktivitet te prokurimit, OSHP ka pranuar dy here ankese, konkretisht OE ankues ”Pro Medical”Sh.p.k , ne herën e pare ka qene i rekomanduar për kontrate ndërsa OE “Atom – Med” ka qene ankues, për te cilin eksperti shqyrtues ka dhënë vlerësimet e veta ne raportin e ekspertizes të datës: 09.08.2024, me nr: 2024/0666.

Lidhur me ankesën e pare, paneli shqyrtues ka nxjerr vendim me nr. 2024/0666 (te datës 24.09.2024).

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues pas përfundimit te rivlerësimit, konform vendimit te PSH-se e njofton OE ankues me arsyen e eliminimit.

Eksperti shqyrtues, konform Rregullores se punës se OSHP-se, i propozon panelit shqyrtues qe ta trajtoje si çështje te gjykuar sepse me datën: 09.08.2024, eksperti shqyrtues ka dhëne sqarimet e veta lidhur me këtë pretendim ne raportin e ekspertizës me nr. 2024/0666 dhe poashtu edhe paneli shqyrtues përmes vendimit me nr: 2024/0666 te datës 24.09.2024. pra, operatori ekonomik ankues ne ankesne e tij ka te njejtin pretendim, i cili eshte trajtuar me pare.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PRO MEDICAL” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PRO MEDICAL” SH.P.K., janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për

Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E PODUJEVËS” të datës 18.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i paisjeve mjekësore” me nr. të prokurimit: 615-24-4154-2-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: